

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Në Tiranë, sot, më 18.12.2023 palët e mëposhtme lidhin këtë kontratë shitblerje kuote:

Burim Ahmeti, shtetas shqiptar, lindur me 07.11.1987, ne Republikën e Kosovës, banues ne adresën "Lagja Kongresit, Pallati Luna Park 2, Kati 8 /1, Lushnje, Shqipëri", mbajtës i pasaportës e me nr. BF0385581, madhor, me zotësi te plote për te vepruar (ne vijim i quajtur "Shitësi")

Antigona Ahmeti, shtetase shqiptar, lindur me 05.10.1989, ne Republikën e Kosovës, banuese ne adresën "Lagja Kongresit, Pallati Luna Park 2, Kati 8 /1, Lushnje, Shqipëri", mbajtëse e pasaportës e me nr. BJ3908642, madhore, me zotësi te plote për te vepruar (ne vijim e quajtur "Dhënësja e Pëlqimit").

dhe

Gjonaj Group Holdings Shpk, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit te Republikës se Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) M22010013H, e seli ne adresën: "Ndërtesa "Park Gate", rruga e Elbasanit, kati i parë, Tiranë, Shqipëri", përfaqësuar rregullisht për qellim te kësaj kontrate nga zj. Kristjana Zhamo, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033450465, ne cilësinë e Administratorit te Gjonaj Group Holdings Shpk, (ne vijim i quajtur "Blerësi")

MEQËNËSE

- A. Shoqëria DONI FRUITS Shpk është një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit L34502401K, (me poshte e quajtur "Shoqëria").
- B. Në datën e këtij akti, Shitësi zotëron një kuotë pjesë e kapitalit themeltar të Shoqërisë që përfaqëson 50% të këtij kapitali ("Kuota").
- C. Sipas termave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë dhe në Marrëveshjen për Shitblerjen e Kuotës, Blerësi kërkon të blejë dhe përftojë dhe Shitësi kërkon të shesë dhe transferojë te Blerësi, Kuotën e tij në Shoqëri. Dhënesja e pelqimit, bashkeshortja e Shitesit deklarone se eshte dakord dhe nuk ka asnje kundërshtim per kete transakcion.
- D. Në kuadër të parashikimeve të ligjit të zbatueshëm për bashkësinë ligjore, është marrë edhe miratimi i Znj. Antigona Ahmeti (bashkëshortes së Z. Burim Ahmeti) e cila nënshkruan gjithashtu në këtë Kontratë.

Palët bien dakord si vijon:

1. Termat më poshtë do të kenë kuptimet si në vijim, përveç kur konteksti që përdoren dikton ndryshe:

- **Kontratë** do të thotë kjo Kontratë Shitje Kuotash, e cila përbën veprimin juridik të vetëm për kalimin e kuotës nga Shitësi tek Blerësi dhe regjistrohet në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
 - **Datë e Kontratës** do të thotë data e nënshkrimit të kësaj Kontrate si më sipër.
 - **Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotës** do të thotë marrëveshja e lidhur midis Shitësit dhe Blerësit datë 23.11.2023.
2. Shitësi i shtet Blerësit dhe Blerësi blen dhe pranon nga Shitësi 1 (një) kuotë që përfaqëson dhe siguron pjesëmarrjen me 50% në kapitalin e Shoqërisë, me garanci të plotë mbi titullin dhe të lirë e të pastër nga çdo e drejtë e ndonjë pale të tretë.
 3. Kuota ka vlerë nominale në shumën totale ALL 142,457,674.00 (njëqind e dyzetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër lekë).
 4. Çmimi i shitjes së kuotës është shlyer në tërësi nga Blerësi përpara datës së kësaj Kontrate, sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen për Shitblerjen e Kuotës.
 5. Titulli i pronësisë mbi Kuotën i transferohet Blerësit me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
 6. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi bëhet ortak zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë, ndërsa Shitësi e humb pronësinë mbi Kuotën dhe nuk do të jetë më ortak në Shoqëri.
 7. Shitësi autorizon nëpërmjet kësaj Kontrate regjistrimin e transferimit të pronësisë së Kuotës si më sipër në emrin dhe pronësinë e Blerësit në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Blerësi do të përgatisë dhe depozitojë të gjitha aplikimet e nevojshme që kërkohen për depozitim dhe regjistrimin e kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
 8. Për çështjet të cilat nuk janë të parashikuara në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj, duke përfshirë edhe përlllogaritjen e tatimeve/taksave që mund të lindin nga transaksioni, do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
 9. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes vetë palëve, kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
 10. Kjo Kontratë përgatitet dhe nënshkruhet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe. Palët deklarojnë se kuptojnë përmbajtjen e saj dhe e nënshkruajnë me vullnet të plotë e të lirë.

[vijon faqja e nënshkrimit]

SHITËSI

Burim Ahmeti

BURIM AHMETI



Dhënëse e pëlqimit

Antigona Ahmeti

ANTIGONA AHMETI



PËR BLERËSIN

Kristjana Zhamo

(administrator)

Kristjana Zhamo

